Voto 4 BINDJA DEMOKRATIKE
ASTRIT PATOZI

Aktualitet

Të armatosur dhe me maska, tre kushërinj grabisin pikën e karburantit në Fushë Krujë! Arrestohen dy prej tyre, shpallet në kërkim tjetri


Dy persona kanë rënë në prangat e policisë ditën e sotme në Krujë dhe një tjetër është shpallur në kërkim, të tre kushërinj me njëri-tjetrin, të akuzuar si autorë të vjedhjes me armë të një karburanti.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
OptButton

Redaksia
12 Prill, 10:58 | Përditesimi i fundit: 12 Prill, 13:25

Dy persona kanë rënë në prangat e policisë ditën e sotme në Krujë dhe një tjetër është shpallur në kërkim, të tre kushërinj me njëri-tjetrin, të akuzuar si autorë të vjedhjes me armë të një karburanti.

Me një njoftim për mediat, Policia bën me dije se ngjarja ndodhi në orët e para të mëngjesit, tek Ura e Gjolës, Arrameras, Fushë Krujë, ku dyshohet se këta persona, të maskuar dhe nën kërcënimin e një arme zjarri kanë grabitur një pikë karburanti, nga ku kanë marrë 120 mijë lekë të vjetra.


LEXO EDHE:
Vjedhjet tek vilat në Liqenin e Thatë, arrestohet famëkeqi Hektor Qiriazi, i dënuar me burg përjetë në Greqi! Në pranga dhe 4 të tjerë

Polici arriti të zbardhte ngjarjen, ndërsa në pranga kanë rënën Skënder Çangu 30 vjeç dhe Zenun Çangu 17 vjeç si dhe u shpall në kërkim Amarildo Çangu, 17 vjeç, banues në Fshatin Verjon, Krujë, kushërinj me njëri-tjetrin.

Policia sekuestroi një armë zjarri pushkë, automjetin dhe veshjet e përdorura nga këta shtetas në momentin e ngjarjes.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, për veprat penale "Vjedhja me armë" kryer në bashkëpunim dhe "Armëmbajtja pa leje".



Objektet e sekuestruara nga policia

J.SH./b.ha./Shqiptarja.com

TAG: fushe kruje | krujë | vjedhje | karburant | Zenun Çangu | Skënder Çangu

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Zgjedhjet e 25 prillit, kush nga liderët po bind më shumë Rama apo Basha?

Rama | Basha | Asnjëri

Komento

Lajme të tjera

Aktualitet



Krisma në Berat, sherr mes 2 familjeve, polici ndërhyn të qetësojë situatën dhe plagoset në këmbë (Emri)
14 Prill, 21:04

Aktualitet




Manastirliu: Sot janë kryer 12.944 vaksinime, mbi 290 mijë në të gjithë që nga fillimi i fushatës 'Shqipëria Buzëqesh'
14 Prill, 21:04

Aktualitet



Automjeti përmbyset në mes të rrugës në autostradën Lezhë-Milot
14 Prill, 19:58

Aktualitet



I dënuar për trafikim heroine në Spanjë, kush është biznesmeni Anton Gjinaj që u prangos në Malin e Zi
14 Prill, 19:44

Aktualitet



Humb 82-vjeçari në Maliq, familjarët apel për ndihmë: Vuan nga probleme të shëndetit mendor
14 Prill, 19:41

Aktualitet



U konfirmua në detyrë, Komisioneri Publik ankimon vendimin e KPK për gjyqtaren e Apelit Tiranë, Elbana Lluri
14 Prill, 19:39



© 2011 - 2021 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje